L I G J
Nr.9127, datë 29.7.2003

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8810, DATË 17.5.2001 "PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË ANONIME "ALBTELECOM""

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8810, datë 17.5.2001 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom"", bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 1, pas paragrafit të dytë shtohen tre paragrafë me këtë përmbajtje:

"Albtelecom" sha i jepet licencë për ofrimin e shërbimit publik telefonik të lëvizshëm, tokësor, sipas standardit GSM, nëpërmjet shoqërisë së re të krijuar, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

Licenca jepet me kusht që:

a) sigurimi i shërbimit të bëhet i bazuar në brezat e frekuencave 900 dhe 1800 MHz;

b) ofrimi i shërbimit të fillojë jo më vonë se 12 muaj nga marrja e licencës;

c) ofrimi i shërbimit të bëhet nga një shoqëri e re, ku "Albtelecom" sha të zotërojë 100 për qind të aksioneve. Kjo shoqëri të lidhë një marrëveshje, në kushte të barabarta, me "Albtelecom" sha, si operatorët e tjerë në treg.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, në zbatim të kushteve të parashikuara në paragrafin e mësipërm, të nenit 52 dhe të neneve vijuese të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", bën lëshimin, ndryshimin ose heqjen e licencës së lëshuar shoqërisë së re, përmendur në paragrafin e mësipërm.".

Neni 2

Në pikën 1 të nenit 2, pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Pjesë e paketës së shitjes së "Albtelecom" sha të jetë dhe shoqëria e re që do të ofrojë shërbimin publik telefonik të lëvizshëm, tokësor, ku partnerit strategjik do t'i ofrohen jo më pak se 51 për qind, por jo më shumë se 76 për qind e aksioneve të kësaj shoqërie.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3934, datë 14.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu